

P.nr.84/16

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti i Përgjithshëm**, gjyqtari, Kujtim Krasniqi, me procesmbajtësin Petrit Nrecaj, në çështjen penale kundër të pandehurit F. N. nga T.-R. Maqedoni, për shkak të veprës penale Prezantim i rrem si person zyrtar nga neni 417, par. 1, të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.12/16, të datës 14.01.2016, jashtë seancës, me datë 14.01.2016, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**PRANOHET** kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë- departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.12/16, të datës 14.01.2016 për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor,

Andaj gjykata konformë nenit 495 të KPPK-së, jep:

**URDHËR NDËSHKIMOR****I akuzuari;**

**F. N.** nga i ati I. dhe e ëma A., i lindur më dt:*data e lindjes...* ne Fshatin Z.-T.-R. Maqedonisë, me vendbanim në L.-Austri, shqiptar – shtetas i Republikës së Austrisë.

**ËSHTË FAJTOR**

**Sepse**, me dt:25.12.2015 rreth orës 16:00 ne lokalin “E. F. në Prishtinë i pandehuri ju ka prezantuar S. A. si pjestar , njeri i Interpolit në autri-L. me adresë H. str,...-.....

**-me këtë ka kryer veprën penale Prezantim i rrem si person zyrtar nga neni 417, par. 1, të KPRK-së,**

Me dt: 12.01.2016 rreth orës 12:00 ne stacionin policorë jugu në Prishtinë i pandehuri gjatë intervistimit është prezantuar si bundës Kriminal Polic i krimeve të rënda në Austri dhe pasë verifikimit nga ambasada e Austrisë dhe atashu P. Sh., ka rezultuar se i pandehuri nuk është punonjës i policisë apo ministrisë të punëve të brendshme të Austrisë.

**-me këtë ka kryer veprën penale Prezantim i rrem si person zyrtar nga neni 417, par. 1, të KPRK-së,**

Andaj gjykata konform neneve 4, 41, 43, 46, 73 të KPK, si dhe neneve 365 e 495, të KPPK-së i shqipton

**PËRCAKTON**

Për veprën penale nga dispozitivi **I** i përcakton dënim me gjobë në shumen prej 100( njëqind euro)  
Për veprën penale nga dispozitivi **II** i përcakton dënim me gjobë në shumen prej 100( njëqind euro)

Konform nenit 80 par.1 të KPRK-së të akuzuarit Gjykata i shqipton:

**DËNIM UNIK ME GJOBË**

në shumë prej **200 (dyqind) Euro**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prere të këtij aktgjykimi.

Po që se dënimi me gjobë nuk mund të realizohet konform nenit 46 të KPK-së, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **në kohëzgjatje prej 15 ditësh duke llogaritur çdo 20 (njëzet) euro me 1 (një) ditë burg.**

**Obligohet;** i akuzuari që të në emër të paushallit gjyqësor, gjykatës t'ia kompensojnë shumën prej **20** euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit me detyrim.

Konform nenit 62 par.2 pika 2.9 të KPRK-së të akzuarit Gjykata i shqipton:

### **DËNIM PLOTËSUES**

Dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës, menjëherë pas ekzekutimit të dënimit dhe ndalimi i tij për të hyrë në Kosovë në periudhën prej **1**(një) viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë- Departamenti i përgjithshëm ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.12/16, të datës 14.01.2016 Kundër të pandehurit F. N. nga T.- R.Maqedoni, për shkak të veprës penale Prezantim i rrem si person zyrtar nga neni 417, par. 1, të KPRK-së,i akzuar sipas aktakuzës dhe kërkesës për dhënien e Urdhrit Ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i çështjes, Gjykatës i ka propozuar që kundër të akzuarit të lëshoj Urdhrit Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazushmërin e aktakuzës së prokurorisë në drejtim të vërtetimit të fakteve të cilat vërtetojnë faktin se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 të KPPK-së Gjyqtari i vetëm gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPK-së dhe vendosi që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: dëshmia e dëshmitarit S. A. të dhenë në polici me dt06.01.2016, dëshmia e dëshmitarit I. V. e A. H., polic në stacionin Policorë "Jugu" në Prishtinë, shkresat e P. Sch. si dhe dokumentacioni që gjendet në shkresat e lëndës, janë prova të mjaftueshme me të cilat vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj Gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë elementet e veprës penale Prezantim i rrem si person zyrtar nga neni 417, par. 1, të KPRK-së, për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale dhe të paushallit gjyqësorë, u mor konform nenit 450 par.1 dhe 2 nën par 2.1 dhe 2.6 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lart, e në bazë të neneve 365 e 495 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
**Departamenti i përgjithshëm-Penal**  
**P.nr.84/16, të dt.14.01.2016**

**Sekretari juridik,**  
 Petrit Nrecaj

**Gjyqtari,**  
 Kujtim Krasniqi

### **KËSHILLA JURIDIKE;**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga marrja e të njëjtit, kësaj Gjykate, pas kalimit të afatit për kundërshtim urdhri ndëshkimor, merr formën e prerë.